



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 200

Tiranë – E hënë, 20 nëntor 2017

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 97/2017, datë 2.11.2017	Për miratimin e buxhetit faktik të shtetit për vitin 2016..... 10473
Ligj nr. 99/2017, datë 9.11.2017	Për disa ndryshime në ligjin nr. 9948, datë 7.7.2008, “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar..... 10473
Ligj nr. 100/2017, datë 9.11.2017	Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit Saudit për Zhvillim për financimin e projektit “Rehabilitimi i rrugës së Lumit të Vlorës” 10474
Ligj nr. 101/2017, datë 9.11.2017	Për ratifikimin e marrëveshjes së garancisë ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe KfW Frankfurt am Main, në lidhje me marrëveshjen e huas ndërmjet Operatorit të Sistemit të Transmetimit sh.a. (OST) dhe KfW Frankfurt am Main, për projektin “Linja e transmetimit 400 kV Shqipëri-Maqedoni (Fier-Elbasan-Qafëthanë)” 10480
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 650, datë 10.11.2017	Për angazhimin e Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për ruajtjen e besimit në statistika..... 10485
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 652, datë 10.11.2017	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 953, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar” 10486
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 653, datë 10.11.2017	Për emërimin e drejtorit ekzekutiv të Autoritetit të Aviacionit Civil..... 10489
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 654, datë 10.11.2017	Për miratimin, si strukturë shëndetësore universitare, të Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza” 10489

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 655, datë 10.11.2017	Për miratimin, si strukturë shëndetësore universitare, të Spitalit Universitar Obstetrik Gjinekologjik “Mbretëresha Geraldinë”, Tiranë	10490
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 656, datë 10.11.2017	Për miratimin, si strukturë shëndetësore universitare, të Spitalit Universitar Obstetrik Gjinekologjik “Koço Gliozheni”, Tiranë.....	10491
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 657, datë 10.11.2017	Për miratimin, si strukturë shëndetësore universitare, të Spitalit Universitar të Traumës.....	10491
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 658, datë 10.11.2017	Për miratimin, si strukturë shëndetësore universitare, të Spitalit Universitar “Shefqet Ndroqi”, Tiranë.....	10492
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 660, datë 10.11.2017	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikualifikim i qendrës së qytetit, loti 1”, Cërrik.....	10492



LIGJ
Nr. 97/2017

PËR MIRATIMIN E BUXHETIT FAKTIK
TË SHTETIT PËR VITIN 2016

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 158, të Kushtetutës, dhe të nenit 63, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Miratimi i buxhetit faktik

Miratohet buxheti faktik i shtetit për vitin 2016, së bashku me burimet e tij të financimit, si më poshtë:

Në milionë lekë

1. Buxheti i shtetit	
Të ardhurat, gjithsej	310 932
Shpenzimet, gjithsej	337 541
2. Buxheti vendor	
Të ardhurat, gjithsej	43 013
Shpenzimet, gjithsej	43 590
3. Buxheti i ISSH-së	
Të ardhurat	115 666
Shpenzimet	114 276
4. Buxheti i FSDKSH-së	
Të ardhurat	35 791
Shpenzimet	34 796
5. Buxheti i AKKP-së	
Të ardhurat, gjithsej	1 645
Shpenzimet, gjithsej	3 519
6. Deficiti buxhetor	-26 675
7. Financimi i deficitit buxhetor	26 675
I brendshëm	8 769
A. Me instrumente financiare	10 608
(kredimarrje e brendshme neto)	
1. Kredimarrje nga pushteti	10 692
qendror	
- Bono thesari	-14 385

- Obligacione qeveritare	25 077
2/3/5/7/10-vjeçare	
2. Kredimarrje nga pushteti vendor	-84
B. Të ardhura nga privatizimi	2 804
C. Të tjera	-4 644
- Ndryshimi i gjendjes së arkës	-414
- Të tjera	-4 230
Financimi i jashtëm (neto)	17 907
Nga i cili: Mbështetje buxhetore	21 126

Neni 2

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 2.11.2017

Shpallur me dekretin nr. 10646, datë 15.11.2017, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta

LIGJ
Nr. 99/2017

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9948, DATË 7.7.2008, “PËR SHQYRTIMIN E VLEFSHMËRISË LIGJORE TË KRIJIMIT TË TITUJVE TË PRONËSISË MBI TOKËN BUJQËSORE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9948, datë 7.7.2008, “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në nenin 17, pika 1/1, shkronja “e”, fjalia e dytë ndryshohet si më poshtë:

“Afati i plotësimit të AMTP-ve përfundon në datën 31 dhjetor 2018.”.



Neni 2

Neni 18 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 18

Verifikimi i titujve të pronësisë, sipas dispozitave të këtij ligji, përfundon më 31 dhjetor 2018.”.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 9.11.2017

Shpallur me dekretin nr. 10647, datë 15.11.2017, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta

LIGJ

Nr. 100/2017

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË HUAS NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE FONDIT SAUDIT PËR ZHVILLIM PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT “REHABILITIMI I RRUGËS SË LUMIT TË VLORËS”

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit Saudit për Zhvillim për financimin e projektit “Rehabilitimi i rrugës së Lumit të Vlorës”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 9.11.2017

Shpallur me dekretin 10648, datë 15.11.2017, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta

Faqe | 10474

Fondi Saudit për Zhvillim

P.O.Box. 50483 Riyadh 11523

Mbretëria e Arabisë Saudite

MARRËVESHJE HUAJE

PROJEKTI I REHABILITIMIT TË RRUGËS SË LUMIT TË VLORËS NDËRMJET FONDIT SAUDIT PËR ZHVILLIM DHE REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

HUA NR.: 693/3

NËNSHKRUAR MË: 14 Shaban 1438 A.H.

QË I KORRESPONDON: 10 maj 2017 A.D.

MARRËVESHJE HUAJE

MARRËVESHJE e datës 14 Shaban 1438 A.H., që i korrespondon 10 maj 2017 A.D., ndërmjet:

1) FONDIT SAUDIT PËR ZHVILLIM, Riad, Mbretëria e Arabisë Saudite (më poshtë i referuar si “Fondi”), i përfaqësuar nga SH.T. z. Mohammed A. Aljenaidel, Drejtor i Përgjithshëm, Departamenti Ligjor; dhe

2) REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË (më poshtë i referuar si “Huamarrësi”), i përfaqësuar nga ministri i Financave i Republikës së Shqipërisë SH.T. z. Arben Ahmetaj, ministër i Financave.

HYRJE

A. *Duke pasur parasysh* se Huamarrësi i ka kërkuar Fondit t’i japë një hua për të ndihmuar për financimin e rehabilitimit të projektit të rrugës së Lumit të Vlorës të përshkruar në shtojcën nr. 2 të kësaj Marrëveshjeje (më poshtë i referuar si “Projekti”):

B. *duke pasur parasysh* se Huamarrësi ka përfutur nga Fondi Kuvajtian për Zhvillimin Ekonomik Arab (më poshtë i referuar si “Fondi Kuvajtian”) një hua në shumën 40,000,000 dollarë amerikanë për ndihmë në financimin e pjesës A të kostos së projektit sipas termave dhe kushteve të përcaktuara në Marrëveshjen e lidhur ndërmjet Huamarrësit dhe Fondit Kuvajtian (më poshtë e referuar si “Marrëveshja e Huas me Fondin Kuvajtian”);

C. *duke pasur parasysh* se qëllimi i Fondit është të asistojë vendet në zhvillim të zhvillojnë ekonomitë e tyre dhe t’i ofrojë atyre huat e nevojshme për zbatimin e projekteve dhe programeve të tyre të zhvillimit;



D. *duke pasur parasysh se* Fondi është i bindur për rëndësinë e Projektit dhe ndikimet e tij me përfitim për zhvillimin ekonomik të popullit mik shqiptar; dhe

E. *duke pasur parasysh se* Bordi i Drejtorëve të Fondit ka rënë dakord, në lidhje me sa më sipër, nëpërmjet rezolutës së tij nr. 14/116/2211 t'i japë huamarrësit një hua sipas termave dhe kushteve të përcaktuara më poshtë:

Palët e kësaj Marrëveshjeje bien dakord si më poshtë:

Neni 1

Kushtet e përgjithshme; përkufizimet

Pika 1.01. Palët e kësaj marrëveshjeje pranojnë të gjitha dispozitat e Kushteve të Përgjithshme të Zbatueshme për Marrëveshjet e Huas së Fondit, të lëshuara me anë të Rezolutës së Bordit të Drejtorëve të Fondit nr. 11/14, e datës Rajab 29, 1396 AH, që korrespondon me datën 26 korrik 1976 PK, me të njëjtën fuqi dhe efekt sikur të ishin përcaktuar plotësisht në këtë marrëveshje (të quajtura Kushte të Përgjithshme të Zbatueshme për Marrëveshjet e Huas së Fondit më poshtë referohen si “Kushtet e Përgjithshme”)

Pika 1.02. Kudo që përdoren në këtë Marrëveshje, përveç rasteve kur konteksti përcakton ndryshe, termat e ndryshëm të përcaktuar në Kushtet e Përgjithshme dhe në hyrjen e kësaj Marrëveshjeje kanë përkufizimet përkatëse të përcaktuara këtu, dhe termi “Agjencia ekzekutuese” i referohet Fondit Shqiptar për Zhvillim.

Neni 2

Huaja

Pika 2.01. Fondi bie dakord t'i japë Huamarrësit hua sipas termave dhe kushteve në Marrëveshjen e Huas së përcaktuar ose referuar, në shumën prej njëqind e dymbëdhjetë milionë e pesëqind mijë (112,500,000) rial saudit.

Pika 2.02. Huamarrësi ka të drejtën të tërheqë shumën nga llogaria e huas në përputhje me dispozitat e shtojcës nr. 1 të kësaj Marrëveshjeje, sikundër kjo shtojcë mund të ndryshohet herë pas here me marrëveshje ndërmjet Fondit dhe Huamarrësit dhe në përputhje me procedurat për tërheqjet e huave të Fondit Saudit për Zhvillim, për shpenzimet e kryera, ose (nëse Fondi bie dakord) për shpenzimet e ardhshme, në lidhje me kostot e

arsyeshme të mallrave dhe shërbimeve të nevojshme për projektin dhe që do të financohen nga të ardhurat e huas.

Pika 2.03. Huamarrësi ndërmerr të përdorë të ardhurat e huas vetëm për financimin e kostove të arsyeshme të mallrave, punimeve dhe shërbimeve të nevojshme për zbatimin e Projektit. Prokurimi i këtyre mallrave, punimeve dhe shërbimeve kryhet në përputhje me “Udhëzimet për prokurimin e mallrave dhe kontraktimin e punimeve të zbatimit”, botimi i parë 2001, dhe me “Përdorimin e konsulentëve të anëtarëve të institucioneve për zhvillim të grupit të koordinimit”, botimi i parë 1995. Huamarrësi do të sigurojë, nëpërmjet Agjencisë Ekzekutuese, miratimin e Fondit para lidhjes së kontratave që do të financohen me të ardhurat e huas dhe para ndërmarrjes së ndryshimeve thelbësore të çdonjërës prej tyre.

Pika 2.04. Data e përfundimit është 28.2.2022 ose një datë e mëvonshme sipas përcaktimit të Fondit. Fondi njofton menjëherë Huamarrësin për datën e mëvonshme.

Pika 2.05. Huamarrësi paguan një tarifë huaje prej dy për qind (2%) në vit të shumës së principalit të huas së tërhequr dhe të pushyer herë pas here.

Pika 2.06. Pagesa e huas dhe pagesat e tjera paguhen një herë në gjashtë muaj, në datat 5 mars dhe 5 shtator të çdo viti.

Pika 2.07. Afati i huas është 25 vjet, duke përfshirë një periudhë pesëvjeçare (5-vjeçare) pa pagesë principal. Huamarrësi shlyen shumën e principalit të huas në përputhje me skedulën e amortizimit të përcaktuar në shtojcën nr. 3 të kësaj Marrëveshjeje. Çdo këst paguhet së bashku me tarifën e huas, pas një njoftimi prej 45 ditësh, që i dërgohet Huamarrësit nga Fondi para afatit të pagesës.

Neni 3

Zbatimi i projektit

Pika 3.01. a) Huamarrësi zbaton Projektin nëpërmjet Agjencisë Ekzekutuese me efikasitet dhe përkushtim dhe, në përputhje me praktikën e përshtatshme administrative, financiare dhe inxhinierike dhe ofron menjëherë, sipas nevojës, fondet, lehtësirat/ambientet, shërbimet dhe burimet e tjera të nevojshme për zbatimin e Projektit.

b) Pa kufizuar përgjithësimin e paragrafit “a” të kësaj pike, Huamarrësi: 1) mundëson menjëherë,



sipas nevojës, të gjitha fondet që nevojiten për zbatimin e projektit (duke përfshirë të gjitha fondet që mund të nevojiten për të mbuluar çdo shtim të kostos përtej kostove të llogaritura në momentin e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje) dhe, nëse këto shuma do të duhet të mundësohen përmes një marrëveshjeje ndërmjet Huamarrësit dhe një pale të tretë, termat dhe kushtet e asaj marrëveshjeje duhet të pranohen nga Fondi; 2) kryen alokime të përshtatshme buxhetore vjetore për të përmbushur pjesën e tij të kostove të Projektit; dhe 3) mbështet çdo kosto shtesë që tejkalon vlerën e huas dhe është e nevojshme për zbatimin e projektit.

Pika 3.02. Huamarrësi merr masa që Agjencia Ekzekutuese t'i mundësojë Fondit, menjëherë pas përgatitjes, planet, specifikimet, raportet, dokumentacionin e kontratës dhe ndërtimit dhe afatet e prokurimit për Projektin, si dhe ndryshimet ose shtesat përkatëse në nivelin e detajeve të kërkuara nga Fondi në mënyrë të arsyeshme.

Pika 3.03. Për mbikëqyrjen e zbatimit të Projektit, Huamarrësi cakton inxhinierë këshilltarë nga lista e përzgjedhur e siguruar nga Fondi, sipas termave dhe kushteve që marrin pëlqimin e Fondit.

Pika 3.04. Për zbatimin e Projektit, Huamarrësi punëson kontraktues të pranueshëm për Fondin sipas termave dhe kushteve që marrin pëlqimin e Fondit.

Pika 3.05. Huamarrësi merr masa që mallrat e importuara që financohen nga të ardhurat e huas sigurohen kundër incidenteve me rrezikshmëri gjatë blerjes, transportit dhe dorëzimit përkatës në pikën e përdorimit apo instalimit dhe, për këtë sigurim, çdo dëmshpërblim është i pagueshëm në një valutë të përdorur lirisht nga Huamarrësi për zëvendësimin apo riparimin e këtyre mallrave.

Pika 3.06. Huamarrësi merr masa që të gjitha mallrat, punimet dhe shërbimet e financuara me të ardhurat e huas përdoren vetëm për zbatimin e Projektit.

Pika 3.07. Huamarrësi merr masa që Agjencia Ekzekutuese:

a) Të mbajë regjistra të përshtatshëm për regjistrimin e ecurisë së Projektit (duke përfshirë kostot përkatëse) për identifikimin e mallrave dhe shërbimeve të financuara me të ardhurat e huas dhe për informimin mbi përdorimin e tyre në Projekt, si dhe për të pasqyruar të gjitha veprimtaritë, burimet dhe shpenzimet e lidhura me Projektin.

b) T'u krijojë të gjitha mundësitë e arsyeshme

përfaqësuesve të akredituar të Fondit që të ndërmarrin vizita për qëllime të lidhura me huan, për të shqyrtuar Projektin, mallrat dhe shërbimet e financuara nga fondet e huas dhe regjistrat dhe dokumentet e tjera përkatëse.

c) T'i ofrojë Fondit informacionin që Fondi kërkon në mënyrë të arsyeshme në lidhje me Projektin, shpenzimet e fondeve të huas dhe mallrat e shërbimet e financuara nga këto fonde.

Pika 3.08. Huamarrësi merr masa që Agjencia Ekzekutuese të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për blerjen, kur është e nevojshme, të të gjithë tokës dhe të drejtave të lidhura me tokën, sipas kërkesave për zbatimin e Projektit.

Neni 4

Marrëveshje të veçanta

Pika 4.01. a) Huamarrësi dhe Fondi konfirmojnë marrëveshjen ndërmjet tyre se asnjë borxh tjetër i jashtëm nuk do të ketë përparësi mbi huan nëpërmjet një barre të krijuar në lidhje me asetet qeveritare. Për këtë qëllim, Huamarrësi ndërmerr që, përveç rasteve kur bihet dakord ndryshe nga ana e Fondit, nëse do të krijohet një barrë mbi ndonjë aset të Huamarrësit, si garanci për ndonjë borxh të jashtëm, kjo barrë do të sigurojë në mënyrë të barabartë dhe proporcionale, dhe si e tillë pa kosto për Fondin, shlyerjen e principalit të huas, tarifën e huas dhe pagesat e tjera të lidhura me huan, dhe që në krijimin e kësaj barre do të hartohet një dispozitë që shprehimisht përcakton sa më lart. b) Pikat e përcaktuara në paragrafin "a" të kësaj pike nuk zbatohen për:

i) të gjitha barrët mbi pronat në momentin e blerjes së tyre, të krijuara vetëm si garanci për pagimin e çmimit të blerjes për këtë pronë;

ii) të gjitha barrët mbi mallra tregtare për të siguruar një borxh që maturohet më shpejt se një vit pas datës në të cilën është krijuar fillimisht dhe që shlyhet nga të ardhurat nga shitja e këtyre mallrave tregtare; ose

iii) të gjitha barrët që rezultojnë nga rrjedha normale e transaksioneve bankare dhe për sigurimin e një borxhi që maturohet më shpejt se një vit nga data e krijimit.

Pika 4.02. Huamarrësi mban ose merr masa për mbajtjen e regjistrave të përshtatshëm në përputhje me praktikën e mira të kontabilitetit, operacioneve, burimeve dhe shpenzimeve në lidhje me Projektin e Agjencisë Ekzekutuese dhe Drejtorive dhe



Agjencive të tjera të Huamarrësit përgjegjëse për zbatimin e Projektit ose të një pjese të tij.

Pika 4.03. Huamarrësi mban sigurime për Projektin kundër rreziqeve dhe në shuma që janë të pajtueshme me praktikën e përshtatshme sipas legjislacionit në fuqi në vendin e tij.

Pika 4.04. Huamarrësi ndërmerr të prodhojë një pllakatë falënderimi me përmasa të përshtatshme, të prodhuar në beton ose një material tjetër të përshtatshëm dhe që do të vendoset në një vend të dukshëm në një prej ambienteve të Projektit, për të treguar kontributin e Fondit në financimin e Projektit.

Pika 4.05. Huamarrësi merr përsipër të sigurojë mirëmbajtjen e përgjithshme të Projektit, duke ndërmarrë inspektime periodike në përputhje me parimet e përshtatshme inxhinierike dhe parashikon caktimet e nevojshme për këtë veprimtari në buxhetin vjetor. Huamarrësi, përmes Agjencisë Ekzekutive, gjithashtu ndërmerr t'i ofrojë Fondit planin e miratuar të mirëmbajtjes, sipas kërkesave të Fondit.

Pika 4.06. Huamarrësi ndërmerr të gjitha ndryshimet e Projektit vetëm pas miratimit paraprak të Fondit.

Pika 4.07. Huamarrësi merr të gjitha masat e nevojshme për t'u siguruar që përmasat dhe ngarkesat për aks të mjeteve që do të përdorin rrugën nuk tejkalojnë kufijtë e përcaktuar në përputhje me standardet e projektimit strukturor dhe gjeometrik të rrugës.

Pika 4.08. Menjëherë pas realizimit të Projektit, por në çdo rast jo më vonë se gjashtë muaj pas datës së përfundimit, ose një datë të mëvonshme për të cilën Fondi bie dakord, Huamarrësi përmes Agjencisë Ekzekutive përpilon dhe i ofron Fondit raportin e realizimit të Projektit, në format dhe detaje të arsyeshme sipas kërkesave të Fondit. Raporti përpilohet për realizimin dhe veprimtarinë fillestare të Projektit, kostot e tij dhe përfitimet prej tij, si dhe përfitimet që do të rrjedhin në të ardhmen, përmbushjen e detyrimeve të Huamarrësit në kuadër të Marrëveshjes së Huas dhe arritjen e qëllimeve të huas.

Neni 5

Mjetet ligjore të Fondit

Pika 5.01. Për qëllimet e pikës 6.02 të Kushteve të Përgjithshme, rastet shtesë më poshtë specifikohen sipas paragrafit “f” të asaj pike:

a) Në bazë të nënpikës b) të kësaj pike:

i) e drejta e Huamarrësit për të tërhequr të ardhurat nga çfarëdolloj huaje apo granti dhënë Huamarrësit për financimin e Projektit të jetë e pezulluar, anuluar apo ndërprerë plotësisht ose pjesërisht, sipas kushteve të marrëveshjes që e parashikon atë; ose

ii) çdo hua e tillë do të jetë bërë e kërkueshme ose e pagueshme para maturimit të saj të rënë dakord.

b) Nënpika “a” e kësaj pike nuk zbatohet nëse Huamarrësi vërteton duke plotësuar kërkesat e Fondit se: i) ky pezullim, anulim, ndërprerje, ose maturim i parakohshëm nuk është shkaktuar nga mospërmbushja nga Huamarrësi e ndonjë prej detyrimeve të tij sipas një marrëveshjeje të tillë; dhe ii) Huamarrësit i mundësohen fonde të përshtatshme për Projektin nga burime të tjera me terma dhe kushte që përputhen me detyrimet e Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje.

Pika 5.02. Për qëllimet e pikës 7.01 të Kushteve të Përgjithshme, rasti i mëposhtëm specifikohet sipas paragrafit “d” të asaj pike dhe, përkatësisht, nëse rasti i përcaktuar në nënpikën “a-ii” të pikës 5.01 të kësaj Marrëveshjeje vërtetohet dhe zgjat për një periudhë që i kalon gjashtëdhjetë 60 ditë nga data në të cilën Fondi e këshillon Huamarrësin në lidhje me vërtetimin e këtij rasti.

Neni 6

Data e hyrjes në fuqi - përfundimit

Periodha prej gjashtë 6 muajsh nga data e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje përcaktohet për qëllimet e pikës 12.04 të Kushteve të Përgjithshme.

Neni 7

Përfaqësuesi i Huamarrësit, adresat

Pika 7.01. Ministri i Financave i Huamarrësit përcaktohet si përfaqësuesi i Huamarrësit për qëllimet e pikës 11.03 të Kushteve të Përgjithshme.

Pika 7.02. Adresat e mëposhtme përcaktohen për qëllimet e pikës 11.01 të Kushteve të Përgjithshme:

PËR FONDIN

Fondi Saudit për Zhvillim

Kutia Postare 50483

Riad, 11523



MBRETËRIA e Arabisë Saudite
Tel.: +966-11-2794000
Telefaks: +966-11-4647450
E-mail: info@sfd.gov.sa

PËR HUAMARRËSIN
Ministria e Financave
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 3
Tiranë, Republika e Shqipërisë
Tel.: + 35542228405
Telefaks: + 35542228494
Email: Ilda.Malile@financa.gov.al

PËR AGJENCINË EKZEKUTUESE
Fondi Shqiptar i Zhvillimit
Rr. “Sami Frashëri”, nr. 10
Tiranë, Republika e Shqipërisë
Tel.: +35542234885
Telefaks: +35542234885
E-mail: adf@albaniandf.org

Në dëshmi të kësaj, palët e kësaj Marrëveshjeje, duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të autorizuar ligjërish, nënshkruan këtë Marrëveshje me emrat e përfaqësuesve, në qytetin Tiranë, Republika e Shqipërisë, në ditën, muajin dhe vitin e shkruar më lart në dy origjinalë në gjuhët arabe dhe angleze dhe secila prej tyre përbën një origjinal. Një kopje e Kushteve të Përgjithshme në të dyja gjuhët i është dhënë Huamarrësit. Nëse ndonjë dispozitë e versionit në gjuhën arabe të Marrëveshjes së Huas dhe/ose Kushteve të Përgjithshme nuk përputhet me dispozitën përkatëse të versionit në gjuhën angleze të Marrëveshjes së Huas dhe/ose Kushteve të Përgjithshme, versioni në gjuhën arabe do të ketë përparësi.

PËR FONDIN SAUDIT PËR ZHVILLIM
Mohammed A. Aljenaidel
Drejtor i Përgjithshëm, Departamenti Ligjor

PËR REPUBLIKËN E SHQIPËRISË
Arben Ahmetaj
Ministër i Financave

SHTOJCA NR. 1
TËRHEQJA E FONDEVE TË HUAS

Tabela më poshtë përcakton kategoritë e zërave që do të financohen me fondet e huas, caktimin e vlerës së huas për çdo kategori dhe përqindjen e shpenzimeve për zërat që do të financohen në çdo kategori.

	Kategoria	Vlera e caktuar e huas (e shprehur në rial saudit)	Përqindja e shpenzimeve që do të financohen
1	Punimet civile Pjesa “1-B” e Projektit	95,000,000	100% e shpenzimeve të përgjithshme
2	Shërbime këshillimi Pjesa “2-B” e Projektit	7,500,000	100% e shpenzimeve të përgjithshme
3	Të pacaktuara	10,000,000	
TOTALI		112,500,000	

B) Pavarësisht dispozitave të paragrafit A më lart, nuk do të kryhet asnjë tërheqje në lidhje me pagesat e kryera për:

- 1) shpenzime para datës së kësaj Marrëveshjeje; dhe
- 2) tatime të caktuara nga ose në territorin e Huamarrësit për mallra ose shërbime, ose mbi importin, prodhimin, prokurimin apo furnizimin e tyre.

C) Pavarësisht caktimit të një shume të huas ose disbursimit të përqindjeve të përcaktuara në tabelën në paragrafin (A) më lart, nëse Fondi ka llogaritur në mënyrë të arsyeshme se vlera e huas e caktuar për kategorinë është e pamjaftueshme për financimin e përqindjes të të gjitha shpenzimeve në atë kategori, të rënë dakord, Fondi, me kërkesë të Huamarrësit, mund të:

i) rialokojë në këtë kategori fonde të huas që në atë moment nuk janë të caktuara ose janë të caktuara për një kategori tjetër dhe që, sipas opinionit të Fondit, nuk janë të nevojshme për të realizuar shpenzimet të tjera; dhe

ii) nëse ky rialokim nuk mund të përmbushë plotësisht mangësinë e llogaritur, të reduktojë disbursimin e përqindjes të zbatueshme në atë moment për këto shpenzime, në mënyrë që tërheqjet e ardhshme në kuadrin e kategorisë të mund të vijojnë derisa të jenë kryer të gjitha shpenzimet përkatëse.



SHTOJCA NR. 2

PËRSHKRIMI I PROJEKTTIT

Qëllimi i Projektit është të forcojë zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të rajonit të Vlorës në jug të vendit, nëpërmjet përmirësimit të shërbimeve të transportit për pasagjerë dhe mallra, duke reduktuar kështu kohën e udhëtimit dhe ulur koston e transportit, përveç përmirësimit të sigurisë së trafikut.

Projekti përfshin rindërtimin dhe rehabilitimin e rreth 94 km në rrugën ekzistuese Vlorë – Peshkëpi – Qeparo dhe rrugën lidhëse me rrugën kombëtare Levan – Tepelenë (përmes Selenicës) dhe zgjerimin e saj në rrugë me dy kalime, me gjerësi 3,5 m dhe brez emergjence 0,75 m nga secila anë, si dhe rindërtimin dhe rehabilitimin e urave ekzistuese, ndërtimin e urave të reja, dhe rindërtimin dhe rehabilitimin e infrastrukturës së sistemit të kullimit, instalimin e sinjalistikës rrugore për përmirësimin e sigurisë rrugore në zonat e populluara urbane, si dhe ofrimin e shërbimeve të Këshillimit për Projektin.

Projekti është i përbërë nga pjesët e mëposhtme:

1. Punimet civile:

Rindërtimi dhe rehabilitimi i pjesës së parë të rrugës me gjatësi të përgjithshme prej 64 km;

Rindërtimi dhe rehabilitimi i pjesës së dytë të rrugës me gjatësi të përgjithshme 30 km.

2. Shërbimet e këshillimit:

A. Shqyrtim i projektit të detajuar, përgatitje e dokumentacionit të tenderit dhe mbikëqyrje e projektit për pjesën “a” të punimeve civile.

B. Shqyrtim i projektit të detajuar, përgatitje e dokumentacionit të tenderit dhe mbikëqyrje e projektit për pjesën “b” të punimeve civile.

Kostoja e përgjithshme e Projektit është rreth (72) milionë USD, e cila është e barabartë me rreth (270) milion rial saudit, dhe projekti pritet të përfundojë në fund të vitit 2020.

SHTOJCA NR. 3

AFATET E AMORTIZIMIT

Kësti nr.	Data e shlyerjes	Vlera e këstit e shprehur në Rial Saudit
1.	15 SHTATOR 2022	2,793,000
2.	15 MARS 2023	2,813,000
3.	15 SHTATOR 2023	2,813,000
4.	15 MARS 2024	2,813,000
5.	15 SHTATOR 2024	2,813,000
6.	15 MARS 2025	2,813,000
7.	15 SHTATOR 2025	2,813,000
8.	15 MARS 2026	2,813,000
9.	15 SHTATOR 2026	2,813,000
10.	15 MARS 2027	2,813,000
11.	15 SHTATOR 2027	2,813,000
12.	15 MARS 2028	2,813,000
13.	15 SHTATOR 2028	2,813,000
14.	15 MARS 2029	2,813,000
15.	15 SHTATOR 2029	2,813,000
16.	15 MARS 2030	2,813,000
17.	15 SHTATOR 2030	2,813,000
18.	15 MARS 2031	2,813,000
19.	15 SHTATOR 2031	2,813,000
20.	15 MARS 2032	2,813,000
21.	15 SHTATOR 2032	2,813,000
22.	15 MARS 2033	2,813,000
23.	15 SHTATOR 2033	2,813,000
24.	15 MARS 2034	2,813,000
25.	15 SHTATOR 2034	2,813,000
26.	15 MARS 2035	2,813,000
27.	15 SHTATOR 2035	2,813,000
28.	15 MARS 2036	2,813,000
29.	15 SHTATOR 2036	2,813,000
30.	15 MARS 2037	2,813,000
31.	15 SHTATOR 2037	2,813,000
32.	15 MARS 2038	2,813,000
33.	15 SHTATOR 2038	2,813,000
34.	15 MARS 2039	2,813,000
35.	15 SHTATOR 2039	2,813,000
36.	15 MARS 2040	2,813,000
37.	15 SHTATOR 2040	2,813,000
38.	15 MARS 2041	2,813,000
39.	15 SHTATOR 2041	2,813,000
40.	15 MARS 2042	2,813,000
SHUMA		112,500,000

**LIGJ**

Nr. 101/2017

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË GARANCISË NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË, DHE KFW FRANKFURT AM MAIN, NË LIDHJE ME MARRËVESHJEN E HUAS NDËRMJET OPERATORIT TË SISTEMIT TË TRANSMETIMIT SHA (OST) DHE KFW FRANKFURT AM MAIN, PËR PROJEKTIN “LINJA E TRANSMETIMIT 400 KV SHQIPËRI-MAQEDONI (FIER-ELBASAN-QAFËTHANË)”

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:**Neni 1**

Ratifikohet marrëveshja e garancisë ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe KfW Frankfurt am Main, në lidhje me marrëveshjen e huas ndërmjet Operatorit të Sistemit të Transmetimit sh.a. (OST) dhe KfW Frankfurt am Main, për projektin “Linja e transmetimit 400 kV Shqipëri-Maqedoni (Fier-Elbasan-Qafëthanë)”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 9.11.2017

Shpallur me dekretin 10649, datë 15.11.2017, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta

MARRËVESHJE GARANCIE

E DATËS 18 PRILL 2017 NDËRMJET KFW, FRANKFURT AM MAIN (KfW) DHE REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË (GARANTUESI), TË PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE NË LIDHJE ME MARRËVESHJEN E HUAS, NË SHUMËN PREJ 50,000,000.00 EURO (PESËDHJETË MILIONË EURO), TË DATËS 18 NËNTOR 2016, NDËRMJET KFW-SË DHE OPERATORIT TË SISTEMIT TË TRANSMETIMIT SHA (OST) (HUAMARRËSI) PËR QËLLIMIN E LINJËS SË TRANSMETIMIT 400 KV SHQIPËRI-MAQEDONI (FIER-ELBASAN-QAFËTHANË) (BMZ NR. 2010 66 992 & 2016 67 898)

Hyrje

Me anë të një marrëveshjeje huaje, të datës 18 nëntor 2016 (Marrëveshja e Huas), ndërmjet Operatorit të Sistemit të Transmetimit (Huamarrësi) dhe KfW-së (KfW), KfW-ja ra dakord që t'i japë një hua Huamarrësit deri në një shumë maksimale 50,000,000.00 euro (Huaja), sipas afateve dhe në bazë të kushteve që përfshihen në Marrëveshjen e Huas.

Zbatimi dhe dorëzimi i kësaj Marrëveshjeje garancie është kusht pararendës i çdo disbursimi sipas Marrëveshjes së Huas.

Afatet dhe kushtet e Marrëveshjes së Huas janë të njohura për Garantuesin. Me anë të kësaj hyrjeje paraprake, Garantuesi pranon sa vijon:

Neni 1

1.1 Garantuesi, në mënyrë të përvokueshme dhe të pakushtëzuar, i garanton KfW-së përmbushjen e duhur të të gjitha detyrimeve për pagesë të Huamarrësit sipas Marrëveshjes së Huas.

1.2 Me kërkesën e parë me shkrim të KfW-së, e cila pohon se Huamarrësi nuk ka realizuar detyrimet e tij për pagesë dhe kur është e nevojshme, Garantuesi do të ridërgojë menjëherë shumat e kërkuara pa asnjë kompensim, rezervim, zbritje, kundërpretendim ose kundërshtim tjetër, ose mbrojtje ekskluzivisht në euro, te llogaria e KfW-së, Frankfurt am Main.

Marrësi: KfW Bankengruppe
SWIFT-BIC:KFWIDEFF
IBAN: DE88 5002 0400 31 97508993



1.3 Detyrimet për pagesë të Garantuesit do të jenë të pavarura nga vlefshmëria e Marrëveshjes së Huas, e çfarëdo konsulence ose kërkesë paraprake për pagesë nga KfW-ja te Huamarrësi, të çdo procedure ligjore ose veprimi tjetër të ndërmarrë nga KfW-ja kundër Huamarrësit, ose çdo të dhënë provuese mosrealizimi të detyrimeve të Huamarrësit për t'u dhënë nga KfW-ja.

Neni 2

Modifikimet ose ndryshimet në Marrëveshjen e Huas kërkojnë miratimin e Garantuesit.

Neni 3

Pa cenuar detyrimet e tjera të Garantuesit sipas kësaj Marrëveshjeje, Garantuesi, duke marrë të gjitha masat e nevojshme ose të duhura, brenda kompetencës së tij dhe në përputhje me praktikat e duhura inxhinierike dhe financiare do të asistojë Huamarrësin në zbatimin dhe funksionimin e Projektit dhe në realizimin e detyrimeve të Huamarrësit sipas Marrëveshjes së Huas.

Neni 4

Për sa kohë që Garantuesi është nën përgjegjësinë aktuale ose të mundshme sipas kësaj Marrëveshjeje, ai nuk do të ketë asnjë të drejtë zëvendësimi në lidhje me çfarëdo shume të paguar nga ai sipas kësaj Marrëveshjeje.

Neni 5

5.1 Përpara disbursimit të parë, Garantuesi do të vërtetojë me shkrim në formë dhe përmbajtje të pranueshme për KfW-në se KfW-ja është e përjashtuar nga të gjitha taksat, tarifat, detyrimet dhe kosto të ngjashme në Shqipëri për të gjitha pagesat që do të kryhen nga Garantuesi sipas kësaj Marrëveshjeje Garancie.

5.2 Në çdo rast, të gjitha pagesat për t'u bërë nga Garantuesi sipas kësaj Marrëveshjeje Garancie do të kryhen pa asnjë zbritje ose mbajtje. Nëse Garantuesi është i detyruar me ligj ose për shkaqe të tjera që të bëjë ndonjë zbritje të tillë ose të mbajë shuma nga çfarëdo pagese për t'u paguar te KfW-ja, atëherë Garantuesi do të kryejë pagesa të tilla shtesë që të sigurojë se KfW-ja merr një shumë neto të barabartë me shumën që do të kishte marrë nëse nuk do të ishte bërë ajo zbritje ose mbajtje.

5.3 Të gjitha taksat tarifat, detyrimet, detyrimet për pulla dhe kosto të ngjashme që mbliidhen për sa i takon lidhjes dhe zbatimit të kësaj Marrëveshjeje garancie jashtë Republikës Federale të Gjermanisë do të mbulohen nga Garantuesi. Çdo kosto e tillë që mbliidhet në Republikën Federale të Gjermanisë do të mbulohet nga Garantuesi nëse shkaktohet prej tij. Nëse një kosto e tillë që do të mbulohet nga Garantuesi i paguhet KfW-së, Garantuesi do të rimbursojë menjëherë sipas kërkesës KfW-në pas paraqitjes së faturave sipas rastit.

5.4 Të gjitha kostot dhe shpenzimet, duke përfshirë shpenzimet ligjore që lindin nga ose në lidhje me përgatitjen, negocimin, zbatimin, regjistrimin, zbatimin, ndryshimin, ruajtjen ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje garancie, të drejtat sipas kësaj Marrëveshjeje ose çfarëdo sigurimi, ose dokumenti që i përket do të mbulohen nga Garantuesi. Nëse çfarëdo kosto ose shpenzim i tillë paguhet nga KfW-ja, Garantuesi do të rimbursojë KfW-në menjëherë sipas kërkesës.

Neni 6

6.1 Garantuesi konfirmon me anë të kësaj Marrëveshjeje se të gjitha autorizimet e nevojshme në Shqipëri për lidhjen dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje Garancie dhe të Marrëveshjes së Huasë janë dhënë siç duhet dhe vazhdojnë të jenë në fuqi dhe efekt të plotë.

6.2 Garantuesi do të njoftojë KfW-në pa vonesë për të gjitha ngjarjet që mund të pengojnë ose rrezikojnë zbatimin e duhur të Marrëveshjes së Huasë ose të kësaj Marrëveshjeje Garancie.

6.3 Garantuesi do të demonstrojë, siç e kërkon KfW-ja, duke paraqitur një opinion ligjor, përmbajtja e të cilit është kryesisht në përputhje me shembullin në aneksin 1 të kësaj Marrëveshjeje, dhe duke paraqitur kopje të vërtetuara (secila me përkthim zyrtar në gjuhën e kësaj Marrëveshjeje Garancie) të të gjitha dokumenteve të cilave u referohet ky opinion ligjor, se Garancia është ligjërisht efikase dhe e zbatueshme dhe në mënyrë të veçantë se Garantuesi ka përmbushur të gjitha kriteret sipas të drejtës kushtetuese dhe të gjitha dispozitat e tjera ligjore që zbatohen për supozimin e vlefshëm të të gjitha detyrimeve të tij sipas kësaj Garancie.



Neni 7

7.1 Kjo Marrëveshje garancie zbatohet dhe interpretohet në përputhje me ligjet e Republikës Federale të Gjermanisë.

7.2 Vendi i realizimit është Frankfurt am Main.

7.3 Të gjitha pretendimet e KfW-së sipas kësaj Marrëveshjeje skadojnë pas pesë vjetësh nga fundi i vitit në të cilën ky pretendim ka lindur dhe kur KfW-ja ka marrë dijeni për rrethanat që përbëjnë këtë pretendim ose mund të ishte vënë në dijeni të tyre pa neglizhencë flagrante.

7.4 Të gjitha mosmarrëveshjet që lindin nga ose në lidhje me këtë Marrëveshje do të zgjidhen ekskluzivisht dhe përfundimisht nga një gjykatë arbitrazhi. Në lidhje me këtë zbatohen sa më poshtë:

a) Gjykata e arbitrazhit do të përbëhet nga një ose tre gjyqtarë që do të emërohen dhe veprojnë në përputhje me Rregullat e Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë (ICC) të zbatueshme herë pas here.

b) Gjykimi në arbitrazh do të kryhet në Frankfurt am Main. Gjuha e procedimit do të jetë anglisht.

7.5 Asnjë pagesë për KfW-në sipas kësaj Marrëveshjeje, qoftë në përputhje me ndonjë vendim ose gjykim ose urdhër të çfarëdo gjykate ose ndryshe nuk do të funksionojë për të përmbushur detyrimin e Garantuesit në lidhje me të cilin është kryer dhe derisa të jetë marrë pagesa e plotë në monedhën e llogarisë të atij detyrimi. Deri në masën që shumën e asaj pagese në çfarëdo konvertimi të nevojshëm në monedhën e llogarisë së duhur të pagesës do të jetë më pak sesa shumën e detyrimit përkatës të shprehur në atë monedhë të llogarisë, Garantuesi do të mbetet me detyrime ndaj KfW-së në atë shumë që sipas konvertimit në monedhën e llogarisë së duhur të pagesës është e barabartë me shumën e munguar.

7.6 Nëse dhe deri në masën që Garantuesi aktualisht ose në të ardhmen në çfarëdo juridiksioni mund të pretendojë imunitet për veten e tij ose asetet e tij dhe deri në masën që një juridiksion i siguron imunitet Garantuesit dhe asetëve të tij nga padia, zbatimi, ndalimi ose proces tjetër ligjor, Garantuesi në mënyrë të përvokueshme pranon të heqë dorë nga ky imunitet për pretendime nga dhe në lidhje me këtë Marrëveshje garancie deri në masën më të plotë të lejuar nga ligjet e atij juridiksioni.

Garantuesi nuk heq dorë nga imuniteti, në lidhje me:

i) “Mjediset aktuale ose të ardhshme të misionit”, siç përcaktohet në Konventën e Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatike, të nënshkruar në vitin 1961, “Mjediset konsullore aktuale ose të ardhshme”, siç përcaktohet në Konventën e Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatike, të nënshkruar në vitin 1963 ose siç përdoret ndryshe nga një diplomat, ose mision diplomatik i Shqipërisë, ose çdo agjenci ose degë e tij;

ii) Çdo pasuri e patundshme, e cila përfshihet në nenin 3, paragrafi 1-3 i ligjit shqiptar nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme shtetërore”;

iii) Çdo fond monetar dhe/ose shumë që duhet të ishte paguar dhe që është paguar aktualisht ose zbatimi për përmbushjen e detyrimeve të Republikës së Shqipërisë sipas të drejtës publike, traktateve, konventave dhe/ose marrëveshjeve ndërkombëtare të nënshkruara prej saj.

7.7 Dispozitat e Marrëveshjes së huas që lidhen me llogaritjen dhe pagesat në përgjithësi (neni 5) do të zbatohen *mutatis mutandis* për çdo pagesë që do të kryhet menjëherë pas kësaj.

7.8 Çdo deklaratë ose njoftim dhe komunikimet në lidhje me këtë Marrëveshje garancie do të dërgohen me letër me postë ajrore ose me teletransmetim në adresat e mëposhtme:

Për KfW-në: KfW

Postfach 11 11 41

60046 Frankfurt am Main

Bundesrepublik Deutschland Faks: +49 69 7431-2944

Për Garantuesin: Republika e Shqipërisë

Përfaqësuar nga Ministria e Financave, bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 1, Tiranë, Shqipëri
Faks: +355 4 222 8494

Çdo deklaratë, njoftim ose komunikim i tillë do të konsiderohet se është marrë:

a) nëse është kryer me letër me postë ajrore, shtatë ditë pasi letra përkatëse është dërguar me postë ajrore rekomandë, tarifë postare të parapaguar; ose

b) nëse është kryer me teletransmetim, kur transmetimi është kryer.

7.9 Nëse ndonjë nga dispozitat e kësaj Marrëveshjeje garancie do të jetë ligjërish e pavlefshme, kjo pavlefshmëri nuk do të ndikojë në



vlefshmërinë e dispozitave të tjera të saj. Çdo boshllëk që rezulton si pasojë do të plotësohet nga një dispozitë në përputhje me frymën dhe qëllimin e kësaj Marrëveshjeje garancie.

7.10 KfW-ja do t'ia kthejë këtë Marrëveshje garancie Garantuesit sapo të gjitha detyrimet e pagesës të Huamarrësit sipas Marrëveshjes së Huas të jenë përmbushur.

7.11 Kjo Marrëveshje garancie hartohet në gjuhën angleze në tri kopje origjinale. KfW-ja do të mbajë një kopje origjinale.

Tiranë, më 11 prill 2017

Për Republikën e Shqipërisë
të përfaqësuar nga Ministria e Financave

Ministër i Financave
Frankfurt am Main, më 18 prill 2017

Për KfW
Jürgen Kern

Përgjegjës i Sektorit të Energjisë për Evropën
Juglindore dhe Turqinë

Nico Schützhafer
Menaxher Projekti i Energjisë për Evropën
Juglindore dhe Turqinë

ANEKSI 1

Formular i Opinioneve Ligjore të Këshilltarit Ligjor për Garantuesin (Shteti)

[Letër me logo e Këshilltarit Ligjor]

(data)

KfW
Palmengartenstrasse 5 - 9
Postfach 11 11 41
D-60325 Frankfurt am Main
Republika Federale e Gjermanisë

Garancia e pagesës e datës _____, e
lëshuar nga _____ (Garantuesi) në
përfitim të KfW-së, Frankfurt am Main (KfW).

Të nderuar zotërinj,

Unë jam ministër i Drejtësisë /këshilltar ligjor i
/drejtues i departamentit ligjor të Garantuesit. Kam
vepruar në këtë cilësi në lidhje me një Garanci
pagese (Garancia), në favorin tuaj, në lidhje me një
hua që do të jepet nga ana juaj për (Huamarrësin)
në një shumë që nuk tejkalon USD/EURO sipas
termave dhe kushteve të marrëveshjes së huas nr.
(Marrëveshja e Huas).

Për qëllim të dhënies së këtij opinioni, kam
shqyrtuar:

A. një kopje të nënshkruar origjinale të
Garancisë dhe të Marrëveshjes së Huas;

B. dokumentet themeluese të Garantuesit,
veçanërisht:

1. Kushtetutën e Republikës së vendit¹ (më
poshtë "Republika"), të datës së publikuar sipas
rregullave në, nr., faqe., të
ndryshuar;

2. Ligji (et) nr. _____ datë _____ të
publikuar/a sipas rregullave _____
nr. _____, faqe _____ të ndryshuar; (*ju lutem
përfshini këtu nëse ka, ligje në lidhje me lëshimin e garancive
nga Republika, për shembull ligjet e buxhetit*).

3. [*Ju lutem referojuni këtu dekreteve ose rezolutave të
organeve qeveritare mbi aktet ose kushtet për sa u përket
garancive të Republikës në përgjithësi ose Garancisë në
veçanti, të publikuara/ të regjistruara sipas rregullave*];

dhe ato ligje, rregullore, vërtetime, të dhëna,
regjistrime dhe dokumente të tjera që i kam
konsideruar të nevojshme ose të kërkueshme për

¹ Ju lutemi bëni ndryshime si të jetë e përshtatshme.



shqyrtim. Përveç kësaj kam kryer kërkimet që i kam konsideruar të nevojshme ose të kërkueshme për qëllimin e dhënies së këtij opinionio.

Për qëllimet e nenit të Marrëveshjes së Huas jam i mendimit që sipas ligjeve të Republikës të kësaj date:

a) sipas seksionit të Kushtetutës/seksionit të ligjit të [ju lutemi specifikoni sipas rastit]

Garantuesi ka të drejtë të lidhë Garancinë dhe ka marrë të gjitha masat e nevojshme për të autorizuar zbatimin, dorëzimin dhe përmbushjen e Garancisë, në mënyrë të veçantë:

1. Rezolutës (ve) nr., të datës të Kabinetit të Ministrave [ose të Komitetit të Garancive Shtetërore / / ju lutem përfshini (shënioni) sipas rastit];

2. [rezoluta, vendime të tjera etj.].

b) Znj./z._(dhe znj./z.) është (janë) të autorizuar sipas rregullave nga që të nënshkruajë individualisht/bashkërisht Garancinë në emër të Garantuesit. Garancia e nënshkruar nga znj./z (dhe znj./z.) është zbatuar sipas rregullave në emër të Garantuesit dhe përbën detyrime ligjërishit detyruese të Garantuesit të zbatueshme ndaj tij ligjërishit në përputhje me kushtet e saj.

c) Për zbatimin dhe përmbushjen e Garancisë nga Garantuesi (duke përfshirë pa kufizim marrjen dhe transferimin të KfW-ja të të gjitha shumave të kërkueshme në monedhat e specifikuar në të), janë marrë aprovimet, autorizimet, lejet, regjistrimet dhe/ose pëlqimet e mëposhtme zyrtare dhe janë në fuqi dhe efekt të plotë:

1. Miratimi nga _____ (Banka Qendrore/Banka Kombëtare), i datës, _____ nr.; _____

2. Miratimi nga _____ [Autoriteti Qeveritar / Ministri i _____], i datës, _____, nr. _____;

3. [ju lutem rendisni çdo autorizim, licencë dhe/ose miratim tjetër zyrtar.]

Asnjë autorizim, miratim, licencë, regjistrim dhe/ose aprovim tjetër zyrtar i një autoriteti ose agjencie qeveritare (duke përfshirë Bankën Qendrore/Kombëtare të Republikës) ose gjykate nuk kërkohet apo nuk rekomandohet në lidhje me zbatimin dhe përmbushjen nga ana e Garantuesit dhe vlefshmërinë dhe zbatueshmërinë e detyrimeve të tij sipas Garancisë. Asnjë taksë vule ose taksë apo tatim i ngjashëm nuk duhet të paguhet në lidhje me vlefshmërinë ose zbatueshmërinë e Garancisë.

d) Zgjedhja e ligjit gjerman sipas të cilit do të zbatohet Garancia dhe paraqitja për arbitrazh dhe juridiksion në përputhje me nenet _____ dhe _____ të Garancisë është e vlefshme dhe detyruese. Vendimet dhe gjykimet e arbitrazhit të marra në gjykatat e Republikës Federale të Gjermanisë ndaj Garantuesit do të njihen dhe do të jenë të zbatueshme në Republikë sipas rregullave të mëposhtme.

e) Gjykatat e Republikës kanë të drejtë të japin vendime të caktuara në monedhën ose monedhat e specifikuar në Garanci.

f) Zbatimi, dorëzimi dhe përmbushja e zbatimit nga Garantuesi i Garancisë përbëjnë akte private dhe tregtare dhe jo akte publike ose qeveritare. As Garantuesi dhe as ndonjë prej sendeve të tij pasurore nuk gëzojnë të drejtë imuniteti nga arbitrazhi, padia, ekzekutimi, sekuestrimi ose procesi tjetër ligjor.

g) Në bazë të [ju lutem specifikoni marrëveshjen përkatëse të tatimit të dyfishtë, si dhe ligjet dhe rregulloret në fuqi në Republikë] Garantuesit nuk do t'i kërkohet të bëjë asnjë zbritje ose mbajtje nga pagesa që Garantuesi duhet të kryejë sipas Garancisë, dhe nëse një zbritje apo mbajtje e tillë duhet të vendoset më vonë, zbatohen dispozitat e nenit të Garancisë për t'i kërkuar Garantuesit që të zhdëmtojë KfW-në sipas rastit.

Si rrjedhojë, detyrimet e Garantuesit sipas Garancisë përbëjnë detyrime të drejtpërdrejta dhe të pakushtëzuara, ligjore, të vlefshme dhe detyruese të Garantuesit, të cilat klasifikohen dhe duhet të klasifikohen të paktën *pari pasu* me të gjitha detyrimet e tashme dhe të ardhshme të Garantuesit dhe janë të zbatueshme ndaj Garantuesit në përputhje me kushtet e tyre.

Ky opinion ligjor kufizohet te ligjet e _____.

_____ (vendi) _____ (data)

_____ (emri)

Ministër i Drejtësisë / Drejtues Departamentit
Juridik / Këshilltar Ligjor

Dokumente të bashkëlidhura:

Shënim. Ju lutem bashkëlidhni kopje të vërtetuara të dokumenteve dhe dispozitave ligjore të përmendura më sipër (në lidhje me ligjet e gjata ose Kushtetutën e Republikës së _____,



një kopje e dispozitave përkatëse duhet të jetë e mjaftueshme), si dhe vini në dispozicion të KfW-së një përkthim të vërtetuar në gjuhën angleze ose gjermane të secilit prej dokumenteve të sipërpërmendura në rastet kur këto dokumente nuk janë lëshuar në anglisht ose gjermanisht si gjuhë zyrtare, përveç rasteve kur KfW-ja ka përcaktuar një gjuhë tjetër si të pranueshme.

VENDIM

Nr. 650, datë 10.11.2017

PËR ANGAZHIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËR RUAJTJEN E BESIMIT NË STATISTIKA²

Në mbështetje të pikës 1, të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Angazhimin e Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për ruajtjen e besimit në statistika, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

² Ky vendim është përafuar pjesërisht me:

1. Rregulloren (KE) nr. 223/2009, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 11 mars 2009, “Mbi statistikave evropiane”, e cila shfuqizon Rregulloren (KE, Euroatom), nr. 1101/2008, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, mbi dërgimin e të dhënave, të cilat i nënshtrohen konfidencialitetit statistikor, Zyrës Statistikore të Komuniteteve Evropiane, Rregulloren e Këshillit (KE) nr. 322/97, “Mbi statistikave të komunitetit” dhe vendimin e Këshillit 89/382/EEC, Euroatom për krijimin e një komisioni mbi programet statistikore të Komuniteteve Evropiane”. Numri CELEX: 32009R0223, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, Seria L, nr. 87, datë 31.3.2009, faqe 164–173.

2. Rregulloren (KE) nr. 2015/759 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 29 prill 2015, e cila ndryshon Rregulloren (KE) nr. 223/2009, për statistikave evropiane. Numri CELEX: 3A32015R0759, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, Seria L, datë 19.5.2015, faqe 123/90–123/97.

ANGAZHIMI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËR RUAJTJEN E BESIMIT NË STATISTIKA

1. Duke marrë parasysh se:

a) statistikave e besueshme janë një element kryesor për proceset informuese, politikëbërëse dhe vendimmarrëse për Këshillin e Ministrave, qytetarët, subjektet private dhe publike;

b) besueshmëria në statistikave zyrtare është parakusht për të rritur dhe garantuar suksesin ekonomik dhe social të vendit;

c) besimi i publikut në statistika kushtëzohet në thelb nga zbatimi i plotë i parimeve të Kodit të Praktikës së Statistikave Evropiane, të cilat janë përafuar plotësisht në ligjin nr. 9180, datë 5.2.2004, “Për statistikave zyrtare”, të ndryshuar dhe, në veçanti, për ruajtjen e pavarësisë profesionale të autoriteteve kombëtare të ngarkuara me ligj për prodhimin e statistikave zyrtare;

ç) cilësia e përgjithshme e statistikave mbështetet, gjithashtu, në cilësinë e burimeve primare të të dhënave;

d) angazhimi për ruajtjen e besimit në statistika rrjedh si objektiv i shteteve anëtare të Bashkimit Evropian, për zbatimin e nenit 11, pikat 3, 4 dhe 5 të Rregullores (KE), nr. 223/2009, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 11 mars 2009, “Mbi statistikave evropiane”, e cila shfuqizon Rregulloren (KE, Euroatom), nr. 1101/2008 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit mbi dërgimin e të dhënave, të cilat i nënshtrohen konfidencialitetit statistikor, Zyrës Statistikore të Komuniteteve Evropiane, Rregulloren e Këshillit (KE), nr. 322/97 “Mbi Statistikave të Komunitetit dhe vendimin e Këshillit 89/382/EEC, Euroatom për krijimin e një komisioni mbi programet statistikore të Komuniteteve Evropiane”, ndryshuar me Rregulloren (KE) të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 29 prill 2015.

2. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë rikonfirmon angazhimin e tij të plotë, për sa vijon:

a) Të respektojë, plotësisht, standardet ndërkombëtare dhe evropiane për cilësinë e statistikave zyrtare, në veçanti parimet e Kodit të Praktikës së Statistikave Evropiane;

b) Të garantojë dhe të mbrojë pavarësinë profesionale të Institutit të Statistikave (INSTAT),



dhe ta promovojë atë në publik nëpërmjet veprimeve të duhura komunikuese;

c) Të mbështesë Institutin e Statistikave në ruajtjen e besimit të publikut në statistikat zyrtare që prodhohen në Republikën e Shqipërisë dhe të mbrojnë stafin e angazhuar në prodhimin statistikor nga çdo përpjekje për të prishur besueshmërinë e tij;

ç) Të sigurojë burimet e përshtatshme dhe të qëndrueshme, të nevojshme për të kryer aktivitetet statistikore dhe për të ruajtur e përmirësuar më tej cilësinë e statistikave zyrtare të Republikës së Shqipërisë;

d) Të raportojë çdo vit në Komisionin Evropian për zbatimin e këtij angazhimi;

dh) Të rishikojë angazhimin e Këshillit të Ministrave për ruajtjen e besimit në statistika, në rast të nevojës për përmirësimin e tij, të identifikuar nga Këshilli i Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ose Komisioni Evropian.

VENDIM

Nr. 652, datë 10.11.2017

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA
NË VENDIMIN NR. 953, DATË 29.12.2014,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
DISPOZITAT ZBATUESE TË LIGJIT NR.
92/2014, “PËR TATIMIN MBI VLERËN E
SHTUAR NË REPUBLIKËN E
SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 159, të ligjit nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 953, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë vijon:

Neni 1

Në nenin 8 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 3 riformulohet, me këtë përmbajtje:

“3. Lista e makinerive dhe pajisjeve, që janë drejtpërdrejt të lidhura me investimin dhe makineritë bujqësore, është përcaktuar në anekset 1 dhe 2, që i bashkëlidhen këtij vendimi. Lista e

kodeve të aneksit 2 aplikohet për importet e subjekteve me aktivitet peshkimi, përfituese të përjashtimit nga taksa e qarkullimit, taksa e karbonit dhe akciza për gazoilin, sipas përcaktimeve në udhëzimin nr. 18, datë 15.6.2015, “Për procedurat dhe kriteret e furnizimit të anijeve të peshkimit me karburant (gazoil), me përjashtim nga taksa e qarkullimit, taksa e karbonit dhe akciza”.”.

2. Shkronja “b”, e pikës 4.2, shfuqizohet dhe në fund të kësaj pike shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Autoriteti doganor e plotëson dokumentacionin e mësipërm me kopje të ekstraktit të Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB), ku të jetë specifikuar se aktiviteti ekonomik është në fushën e përpunimit aktiv. Gjithashtu, verifikimi nëse ka ose jo autorizimin e lëshuar nga autoriteti doganor si tatimpagues në regjimin e përpunimit aktiv kryhet brenda strukturave doganore.”.

3. Shkronja “b”, e pikës 4.3, shfuqizohet dhe në fund të kësaj pike shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Autoriteti doganor e plotëson dokumentacionin e mësipërm me kopje të ekstraktit të QKB-së, ku të jetë specifikuar se aktiviteti ekonomik është në fushën e agrobiznesit.”.

4. Shkronjat “b” dhe “c”, të pikës 4.4, shfuqizohen dhe në fund të kësaj pike shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Autoriteti doganor e plotëson dokumentacionin e mësipërm me vërtetimin nga Drejtoria Rajonale Tatimore se importuesi është person i tatueshëm, që i nënshtrohet regjimit të biznesit (ndërmarrjeve) të vogël dhe ushtron aktivitet prodhues, si dhe me kopje të ekstraktit të QKB-së.”.

5. Në pikën 4.5, paragrafi i tretë, që fillon me fjalët “... Në rastin e tatimpaguesve të tjerë ...”, shkronjat “b” dhe “c” shfuqizohen dhe në fund të kësaj pike shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Autoriteti doganor e plotëson dokumentacionin e mësipërm me vërtetimin nga Drejtoria Rajonale Tatimore se importuesi është person i tatueshëm, si dhe me kopje të ekstraktit të QKB-së.”.

Neni 2

Në nenin 11 bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë vijon:

Pika 1 ndryshon, me këtë përmbajtje:



“1. Në zbatim të nenit 117, të ligjit, kufiri minimal i regjistrimit për tatimin mbi vlerën e shtuar është qarkullimi prej 2 000 000 (dy milionë) lekësh në një vit kalendarik, përveç rasteve të përcaktuara në pikat 2 dhe 3, të këtij neni.”

2. Në pikën 2, fjalët “... si dhe kryejnë veprimtari ekonomike në fushën e hotelerisë ...”, hiqen.

3. Pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“3. Kufiri minimal i regjistrimit për tatimin mbi vlerën e shtuar, për prodhuesit bujqësorë që i nënshtrohen regjimit të veçantë, skema e kompensimit të prodhuesve bujqësorë, është qarkullimi prej 5 000 000 (pesë milionë) lekësh në një vit kalendarik.”

Neni 3

Pas nenit 11 shtohet neni 11/1, me këtë përmbajtje:

“Neni 11/1

Kushtet, kriteret dhe procedurat për zbatimin e shkallës së reduktuar për furnizimin e shërbimit të akomodimit në strukturat akomoduese

1. Në zbatim të pikës 3, të nenit 49, të ligjit, shkalla e reduktuar e tatimit mbi vlerën e shtuar, e cila aplikohet për furnizimin e shërbimit të akomodimit në strukturat akomoduese, sipas kategorive të përcaktuara në legjislacionin e fushës së turizmit, është 6 për qind.

Për qëllime të zbatimit të shkallës së reduktuar të TVSH-së, me termin “furnizim i shërbimit të akomodimit” nënkuptohet furnizimi i shërbimit të fjetjes në strukturat akomoduese, sipas legjislacionit për turizmin, pa përfshirë furnizimin e ushqimit apo çdo furnizim tjetër, të ofruar nga këto struktura. Përfshirë, “furnizimi i shërbimit të akomodimit” nënkupton, përveç shërbimit të fjetjes, edhe furnizimin e ushqimit (mëngjesit), në rastet kur struktura akomoduese e ofron mëngjesin brenda çmimit të furnizimit të shërbimit të fjetjes.

Personi i tatueshëm, i cili ushtron veprimtari në fushën e akomodimit në strukturat akomoduese,

sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës për turizmin, evidenton veçmas në faturë furnizimin e shërbimit të akomodimit, për të cilin aplikon shkallën e reduktuar të TVSH-së, në masën 6 për qind. Për çdo furnizim tjetër të tatueshëm, të ofruar në strukturat akomoduese, personi i tatueshëm aplikon shkallën standarde të TVSH-së, 20 për qind, sipas përcaktimeve në ligjin për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë.

Personat e tatueshëm, që aplikojnë shkallën e reduktuar të TVSH-së sipas këtij neni, janë personat që ushtrojnë vetëm veprimtari ekonomike në fushën e strukturave akomoduese, sipas legjislacionit të fushës për turizmin. Nëse personi i tatueshëm ushtron edhe veprimtari të tjera, përveç asaj në fushën e strukturave akomoduese, atëherë duhet të jetë i regjistruar si person i tatueshëm më vete, për qëllime të veprimtarisë në fushën e strukturave akomoduese.

Aplikimi i shkallës së reduktuar të TVSH-së nuk kufizon të drejtën e zbritjes së TVSH-së. Zbritja e TVSH-së lind dhe ushtrohet në përputhje me përcaktimet e ligjit për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë.

2. Në përputhje me pikën 1, të këtij neni, me qëllim aplikimin e shkallës së reduktuar të TVSH-së, personat e tatueshëm, të cilët, përveç veprimtarisë në fushën e strukturave akomoduese, kryejnë edhe veprimtari të tjera, regjistrohen në Qendrën Kombëtare të Biznesit si persona të tatueshëm më vete, duke riorganizuar ose jo veprimtarinë e tyre ekonomike, siç përcaktohet në ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.”

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare, me përjashtim të pikës 1, të nenit 2, të këtij vendimi, e cila hyn në fuqi në datën 1 prill 2018.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



ANEKS 2

Kodi tarifor	Përshkrimi
54011018	---- Të tjera
54081000	- Pëlhura të endura fituar nga fije të viskozitetit të lartë, prej rajon viskoze
54082100	-- Të zbardhura apo të pazbardhura
540822	-- Të ngjyrosura
54082300	Prej fijeve të ngjyrave të ndryshme
54082400	-- Të stampuara
54083100	-- Të pazbardhura apo të zbardhura
54083200	-- Të ngjyrosura
54083300	-- Prej fijeve të ngjyrave të ndryshme
54083400	-- Të stampuara
56075019	---- Të tjera
56075090	-- Prej fibrave të tjera sintetike
560811	-- Rrjeta të ndërtuara për peshkim
73121020	-- Prej çeliku të pandryshkshëm
73129000	- Të tjera
73160000	Spiranca për anije dhe spiranca për barka dhe pjesët e tyre, prej gize apo çeliku
840721	- Motorët e jashtëm
840729	-- Të tjera
840810	Motorët e shtytjes përpara të marinës
84131900	-- Të tjera
84136061	---- Me fuqi hidraulike me lëng
841810	- Ftohës-ngrirësat e kombinuar, të përshtatur me dyer të jashtme të veçanta
841830	- Ngrirës të tipit pingul (me hapje nga lart), që nuk e kalojnë një kapacitet prej 800 l
841840	- Ngrirës të tipit dollap (me hapje ballore), që nuk e kalojnë një kapacitet prej 900 l:
841850	- Të tjera mobilieri (kabinete, dollapë, banakë, numëruar me afishim dhe të ngjashme) për ruajtjen dhe shfaqjen, ftohës të trupëzuar apo dhe të ngjashëm) për ruajtjen dhe shfaqjen, ftohës të trupëzuar apo pajisje ngrirëse
841861	-- Pompat e nxehtësisë ndryshe nga makinat e ajrit të kondicionuar të kreut 8415
841869	-- Të tjera
84254200	-- Krikët dhe ngritësit e tjerë, hidraulike
84263000	- Vinçat me krah portal apo pedestal
84269900	-- Të tjera
84821090	-- Të tjera
84871010	-- Prej bronzi
84871090	-- Të tjera
85123090	-- Të tjera



85308000	– Pajisje të tjera
890200	Anijet e peshkimit; vaporet fabrike dhe anije të tjera për përpunimin apo ruajtjen e produkteve të peshkimit
89069091	– – – Me peshë jo më shumë se 100 kg secila
89069099	– – – Të tjera
90141000	– Busullat për gjetjen e drejtimit
90142020	– – Sisteme navigimi inerciale
90142080	– – Të tjera
90148000	– Instrumente dhe pajisje të tjera
90151010	– – Elektronike
90151090	– – Të tjera
90153010	– – Elektronike
90153090	– – Të tjera
90173000	– Mikrometrat, kaliperat dhe veglat matëse
901780	Instrumente të tjera
90258080	– – – Të tjera
90262020	– – Elektronik
90262080	– – – Të tjera
9507	Kallamat e peshkimit, grepat dhe pajime të tjera të peshkimit; rrjetat e vendosjes së peshkut, rrjetat e fluturave dhe rrjetat e vendosjes së peshkut, rrjetat e fluturave dhe rrjetat e ngjashme; “zogjtë” për karrem (përveç atyre të kreut 9208 apo 9705) dhe pajisjet e tjera të gjuetisë.

VENDIM

Nr. 653, datë 10.11.2017

**PËR EMËRIMIN E DREJTORIT
EKZEKUTIV TË AUTORITETIT TË
AVIACIONIT CIVIL**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 12, të ligjit nr. 10233, datë 11.2.2010, “Për Autoritetin e Aviacionit Civil”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Emërimin e z. Krislen Keri, drejtor ekzekutiv i Autoritetit të Aviacionit Civil.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 654, datë 10.11.2017

**PËR MIRATIMIN, SI STRUKTURË
SHËNDETËSORE UNIVERSITARE, TË
QENDRËS SPITALORE UNIVERSITARE
“NËNË TEREZA”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 28, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, si strukturë shëndetësore universitare e përgjithshme, e cila realizon funksione diagnostikuese e trajtuese në përmbushje të ofrimit të kujdesit shëndetësor terciar, si pjesë e ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, si dhe funksione mësimore e kërkimore-shkencore për të realizuar formimin universitar të specialistëve të shëndetësisë, si pjesë e Universitetit të Mjekësisë Tiranë.



2. Mënyra e funksionimit të Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, si strukturë shëndetësore universitare, përcaktohet në statutin e saj, i cili miratohet me urdhër të përbashkët të ministrit përgjegjës për arsimin dhe ministrit përgjegjës për shëndetësinë.

3. Departamentet përkatëse të Universitetit të Mjekësisë Tiranë, që përbëhen nga shërbime në bazë specialiteti, propozojnë fushat e mësimdhënies e të kërkimit shkencor për shërbimet shëndetësore universitare, që ofron Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, të cilat miratohen me urdhër të përbashkët të ministrit përgjegjës për shëndetësinë dhe ministrit përgjegjës për arsimin.

4. Në vendimin nr. 70, datë 15.2.2001, të Këshillit të Ministrave, “Për statusin e spitaleve universitare”, të ndryshuar, të gjitha dispozitat, që i referohen Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, shfuqizohen.

5. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Universiteti i Mjekësisë Tiranë dhe Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza” për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 655, datë 10.11.2017

PËR MIRATIMIN, SI STRUKTURË SHËNDETËSORE UNIVERSITARE, TË SPITALIT UNIVERSITAR OBSTETRIK GJINEKOLOGJIK “MBRETËRESHA GERALDINË”, TIRANË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 28, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin, si strukturë shëndetësore universitare e profilizuar të Spitalit, Universitar Obstetrik Gjinekologjik “Mbretëresha Geraldinë”,

Tiranë, i cili realizon funksione diagnostikuese e trajtuese në përmbushje të ofrimit të kujdesit shëndetësor terciar, si pjesë e ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, si dhe funksione mësimore e kërkimore-shkencore për të realizuar formimin universitar të specialistëve të shëndetësisë, si pjesë e Universitetit të Mjekësisë Tiranë.

2. Mënyra e funksionimit të Spitalit Universitar Obstetrik Gjinekologjik “Mbretëresha Geraldinë”, Tiranë, si strukturë shëndetësore universitare, përcaktohet në statutin e tij, i cili miratohet me urdhër të përbashkët të ministrit përgjegjës për arsimin dhe ministrit përgjegjës për shëndetësinë.

3. Departamentet përkatëse të Universitetit të Mjekësisë Tiranë, që përbëhen nga shërbime në bazë specialiteti, propozojnë fushat e mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor për shërbimet shëndetësore universitare, që ofron Spitali Universitar Obstetrik Gjinekologjik “Mbretëresha Geraldinë”, Tiranë, të cilat miratohen me urdhër të përbashkët të ministrit përgjegjës për shëndetësinë dhe ministrit përgjegjës për arsimin.

4. Në vendimin nr. 70, datë 15.2.2001, të Këshillit të Ministrave, “Për statusin e spitaleve universitare”, të ndryshuar, të gjitha dispozitat që i referohen Spitalit Universitar Obstetrik Gjinekologjik “Mbretëresha Geraldinë”, Tiranë, shfuqizohen.

5. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Universiteti i Mjekësisë Tiranë dhe Spitali Universitar Obstetrik Gjinekologjik “Mbretëresha Geraldinë”, Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



VENDIM
Nr. 656, datë 10.11.2017

PËR MIRATIMIN, SI STRUKTURË SHËNDETËSORE UNIVERSITARE, TË SPITALIT UNIVERSITAR OBSTETRIK GJINEKOLOGJIK “KOÇO GLIOZHENI”, TIRANË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 28, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Spitalit Universitar Obstetrik Gjinekologjik “Koço Gliozheni”, si strukturë shëndetësore universitare e profilizuar, e cila realizon funksione diagnostikuese e trajtuese në përmbushje të ofrimit të kujdesit shëndetësor terciar, si pjesë e ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, si dhe funksione mësimore e kërkimore-shkencore për të realizuar formimin universitar të specialistëve të shëndetësisë, si pjesë e Universitetit të Mjekësisë Tiranë.

2. Mënyra e funksionimit të Spitalit Universitar Obstetrik Gjinekologjik “Koço Gliozheni”, Tiranë, si strukturë shëndetësore universitare, përcaktohet në statutin e tij, i cili miratohet me urdhër të përbashkët të ministrit përgjegjës për arsimin dhe ministrit përgjegjës për shëndetësinë.

3. Departamentet përkatëse të Universitetit të Mjekësisë Tiranë, që përbëhen nga shërbime në bazë specialiteti, propozojnë fushat e mësimdhënies e të kërkimit shkencor për shërbimet shëndetësore universitare, që ofron Spitali Universitar Obstetrik Gjinekologjik “Koço Gliozheni”, Tiranë, të cilat miratohen me urdhër të përbashkët të ministrit përgjegjës për shëndetësinë dhe ministrit përgjegjës për arsimin.

4. Në vendimin nr. 70, datë 15.2.2001 të Këshillit të Ministrave, “Për statusin e spitaleve universitare”, të ndryshuar, të gjitha dispozitat që i referohen Spitalit Universitar Obstetrik Gjinekologjik “Koço Gliozheni”, Tiranë, shfuqizohen.

5. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Spitali Universitar Obstetrik Gjinekologjik “Koço Gliozheni”, Tiranë, dhe Universiteti i Mjekësisë Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 657, datë 10.11.2017

PËR MIRATIMIN, SI STRUKTURË SHËNDETËSORE UNIVERSITARE, TË SPITALIT UNIVERSITAR TË TRAUMËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 28, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Spitalit Universitar të Traumës, si strukturë shëndetësore universitare e përgjithshme, e cila realizon funksione diagnostikuese e trajtuese në përmbushje të ofrimit të kujdesit shëndetësor terciar, si pjesë e ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, si dhe funksione mësimore e kërkimore-shkencore për të realizuar formimin universitar të specialistëve të shëndetësisë, si pjesë e Universitetit të Mjekësisë Tiranë.

2. Mënyra e funksionimit të Spitalit Universitar të Traumës, si strukturë shëndetësore universitare, përcaktohen në statutin e tij, i cili miratohet me urdhër të përbashkët të ministrit përgjegjës për arsimin dhe ministrit përgjegjës për shëndetësinë.

3. Departamentet përkatëse të Universitetit të Mjekësisë Tiranë, që përbëhen nga shërbime në bazë specialiteti, propozojnë fushat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor për shërbimet shëndetësore universitare, që ofron Spitali Universitar i Traumës, të cilat miratohen me urdhër të ministrit përgjegjës për shëndetësinë dhe ministrit përgjegjës për arsimin.



4. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Mbrojtjes, Universiteti i Mjekësisë Tiranë, si dhe Spitali Universitar i Traumës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 658, datë 10.11.2017

PËR MIRATIMIN, SI STRUKTURË SHËNDETËSORE UNIVERSITARE, TË SPITALIT UNIVERSITAR “SHEFQET NDROQI”, TIRANË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 28, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin, si strukturë shëndetësore universitare e përgjithshme, të Spitalit Universitar “Shefqet Ndroqi”, Tiranë, i cili realizon funksione diagnostikuese e trajtuese në përmbushje të ofrimit të kujdesit shëndetësor terciar, si pjesë e ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, si dhe funksione mësimore e kërkimore-shkencore për të realizuar formimin universitar të specialistëve të shëndetësisë, si pjesë e Universitetit të Mjekësisë Tiranë.

2. Mënyra e funksionimit të Spitalit Universitar “Shefqet Ndroqi”, Tiranë, si strukturë shëndetësore universitare, përcaktohet në statutin e tij, i cili miratohet me urdhër të përbashkët të ministrit përgjegjës për arsimin dhe ministrit përgjegjës për shëndetësinë.

3. Departamentet përkatëse të Universitetit të Mjekësisë Tiranë, që përbëhen nga shërbime në bazë specialiteti, propozojnë fushat e mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor për shërbimet shëndetësore universitare, që ofron Spitali Universitar “Shefqet Ndroqi”, Tiranë, të cilat miratohen me urdhër të përbashkët të ministrit përgjegjës për shëndetësinë dhe ministrit përgjegjës për arsimin.

4. Në vendimin nr. 70, datë 15.2.2001, të Këshillit të Ministrave, “Për statusin e spitaleve universitare”, të ndryshuar, të gjitha dispozitat që i referohen Spitalit Universitar “Shefqet Ndroqi”, Tiranë, shfuqizohen.

5. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Universiteti i Mjekësisë Tiranë dhe Spitali Universitar “Shefqet Ndroqi”, Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 660, datë 10.11.2017

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “RIKUALIFIKIM I QENDRËS SË QYTETIT, LOTI 1”, CËRRIK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, si dhe të nenit 5, pika 1, 20 dhe 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikualifikim i qendrës së qytetit, loti 1”, Cërrik.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Cërrik.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë sipërfaqe tokë “truall” dhe objekt shërbimi, me një vlerë të përgjithshme prej 2 996 124 (dy milionë e nëntëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e njëqind e njëzet e katër) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 2 996 124 (dy milionë e nëntëqind e nëntëdhjetë e



gjashtë mijë e njëqind e njëzet e katër) lekësh, do të përballohet nga buxheti i Bashkisë Cërrik.

Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2017, miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

5. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare.

6. Pronarët e listës, që i bashkëlidhet këtij vendimi, do të kompensohen për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Bashkisë Cërrik.

7. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Elbasan, brenda 30 ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Cërrik, të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit, mbi hartën treguese të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe të bëjnë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

8. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Elbasan të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në momentin që të realizohet procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit, si dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

9. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Elbasan dhe Bashkia Cërrik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



TË DHËNAT MBI LISTËN EMËRORE TË PRONARËVE DHE PRONAVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR OBJEKTIN
“RIKUALIFIKIMI I QENDRËS SË QYTETIT ÇËRRIK”, BASHKIA ÇËRRIK

1. Objektet që janë në rrugën “Jorgji Dilo”, me certifikatë pronësie (për objekte, shërbimit dhe truallin)

Nr.	Emër, atësia, mbiemër	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Sipërfaqja e objektit të banimit (m ²)	Sipërfaqja e truallit (m ²)	Sipërfaqja e objektit të shërbimit (m ²)	Çmimi i objektit të banimit (lekë/m ²)	Çmimi truall (lekë/m ²)	Vlera e objektit të shërbimit sipas situacionit (lekë)	Vlera e amortizimit për ndërtesat (koha e vënies në funksion 20-vjet/1% në vit)	Vlera e mbetur e objektit të shërbimit (lekë)	Vlera e truallit (lekë)	Vlera totale e truallit, objektit të banimit dhe të shërbimit (lekë)	Dokumenti i pronësisë
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	12		13	14	15
1	Arben Naun Qosja	1389	1.175-N	S'ka	50.00	50.00	S'ka	419	1776145	309,345	1,466,800	20,950	1,487,750	Konfirmuar nga ZRRPP-ja Elbasan
2	Eduart Bajram Velaj	1389	1.77-N	S'ka	0.00	72.00	S'ka	419	1,989,065	480,691	1,508,374	shtet	1,508,374	Saktësim dokumentacioni
												TOTAL	2,996,124	

Shënim. 1. Vlerësimi i ndërtimit është bërë në përputhje me udhëzimin nr. 4, datë 30.9.2015, “Për miratimin e kostos mesatare të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave për vitin 2015”, si dhe udhëzimit nr. 21, datë 26.2.2009, të Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Drejtësisë.

Shënim 2. Trualli është vlerësimi sipas VKM-së nr. 89, datë 3.2.2016.

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2017

Adresa: Rr "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel/fax +355 4 24 27 004 Tel +355 4 24 27 006

Çmimi 196 lekë